




Konferenca Ndërkombëtare e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mjedisit

24 - 25 Shtator 2015



UNIVERSITETI “FAN S. NOLI”, FAKULTETI I BUJQËSISË, KORÇË, SHQIPËRI

NË BASHKËPUNIM ME

**UNIVERSITETIN BUJQËSOR TË TIRANËS,
UNIVERSITETIN E PRISHTINËS, “HASAN PRISHTINA”, KOSOVË,
UNIVERSITETIN SHTETËROR TË TETOVËS, MAQEDONI,
KËSHILLIN E QARKUT, KORÇË,
DREJTORINË RAJONALE TË BUJQËSISË, QARKU KORÇË,
AUTORITETIN KOMBËTAR TË USHQIMIT, KORÇË,
QENDRËN E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE, KORÇË.**

ME MBËSHTETJEN E

**MINISTRISË TË ARSIMIT DHE SPORTIT
MINISTRISË TË BUJQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL DHE ADMINISTRIMIT TË
UJËRAVE**

ORGANIZOJNË:

**KONFERENCËN E II^{TË} NDËRKOMBËTARE TË BUJQËSISË, USHQIMIT
DHE MJEDISIT**



**25 SHTATOR 2015
Korçë, Shqipëri
Mjediset e Universitetit “Fan S. Noli”**

THIRJA E DYTË

Ftesë

Jeni të ftuar të merrni pjesë në Konferencën e II-të ndërkombëtare të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mjedisit, Korçë 2015 me komunikim gojor ose prezantim me poster, si përfaqësues i institucionit/kompanisë tuaj ose si një pjesëmarrës.

Qëllimi kryesor i Konferencës është të mbledhë së bashku kërkues dhe shkencëtarë të interesuar për të bërë prezent dhe diskutuar rezultatet e punës së tyre kërkimore dhe profesionale dhe në këtë mënyrë të mundësojnë një transferim më të mirë të arritjeve profesionale dhe shkencore në fushat e bujqësisë, ushqimit dhe mjedisit. Ne gjithashtu dëshirojmë të vendosim një bashkëpunim më të mirë midis kërkuesve të universiteteve, institucioneve kërkimore dhe specialistëve të këtyre fushave, nga Shqipëria, Ballkani dhe vende të tjera.

Programi i Konferencës do të organizohet në seksionet e mëposhtme:

1. **Prodhim bimor**
2. **Prodhim shtazor**
3. **Bujqësia dhe mjedisi**
4. **Teknologjia dhe siguria ushqimore**
5. **Ekonomia bujqësore dhe zhvillimi rural**
6. **Politikat e zhvillimit bujqësor dhe rural**

Materialet që nuk përfshihen direkt në seksionet e listuara dhe që i përkasin sferave të bujqësisë, ushqimit dhe mjedisit do të bashkëngjiten njërit prej seksioneve ekzistuese. Prezantimi i posterave do të organizohet në bazë seksioni ose duke i grupuar në fusha të përafërta.

Gjuha zyrtare

Gjuhët zyrtare të Konferencës janë shqipja dhe anglishtja. Pjesëmarrësit me prezantim gojor në gjuhën shqipe mund të kenë prezantimin në PowerPoint në gjuhën angleze.

Prezantimi në Konferencë do të jetë gojor ose poster. Koha e prezantimit gojor 12 minuta. Përmasat e posterit do të jenë 100x80 cm.

Dorëzimi i Abstraktit

Një abstrakt me jo më shumë se 250 fjalë në shqip dhe në anglisht duhet të dorëzohet para **19 Qershor 2015**. Autori do të marrë një njoftim me e-mail për pranimin/ refuzimin e kërkimit të tij deri më **31 Korrik 2015**. Dorëshkrimi i plotë duhet të paraqitet deri në **16 Tetor 2015**.

Autori duhet të përcaktojë me kohë se në cilin seksion dëshiron ta paraqesë punimin dhe mënyrën e paraqitjes, duke plotësuar formën e aplikimit si me poshtë, të cilën duhet ta dërgojë në të njëjtën kohë me abstraktin në rrugë elektronike si attached file në e-mail: icafe2015@gmail.com

Publikimi

Autorët pjesëmarrës në konferencën **ICAFE 2015** mund ti publikojnë artikujt e tyre në Proceeding-un e konferencës ose në Buletinin shkencor të Universitetit gjatë vitit 2016. Autorët kanë të drejtë rishikimin e punimit dhe duhet të paraqesin formën përfundimtare të tij pas mbajtjes të konferencës **ICAFE 2015**. Megjithatë, ne premtojmë një proces të përshpejtuar dhe publikim të të gjithë artikujve të pranuar në një numër të vetëm. Dërgimi i dorëshkrimit të rishikuar pranohet deri më **16 Tetor 2015**.

Kalendari do të jetë si më poshtë:

Nr.	Aktiviteti	Data
1	Dorëzimi i abstraktit	19 Qershor 2015
2	Përgjigja e pranimit ose refuzimit të abstraktit	31 Korrik 2015
3	Pagesa për pjesëmarrje në konferencë	4 Shtator 2015
4	Organizimi i Konferencës ICAFE 2015	25 Shtator 2015
5	Dorëzimi i Punimit të plotë	16 Tetor 2015

Tarifa e regjistrimit

Afati i regjistrimit në konferencë është 4 Shtator 2015

Tarifa e regjistrimit prej 50 € [ose 7000 ALL] për çdo artikull mbulon të gjitha materialet e konferencës, distinktivin, koktejin e mirëseardhjes dhe bufetë gjatë pushimeve.

Taksa e regjistrimit do të paguhet në llogarinë si në formularin e bashkëngjitur, me shënimin: “Për pjesëmarrje në konferencë ICAFE-2015”.

Komiteti Shkencor

Prof. as. dr. Irena Kallço (Shqipëri)
Prof. as. dr. Gjergji Mero (Shqipëri)
Prof. dr. Ardian Maçi (Shqipëri)
Prof. dr. Kristaq Teneqexhi (Shqipëri)
Prof. dr. Mynyr Koni (Shqipëri)
Prof. dr. Bahri Musabelliu (Shqipëri)
Prof. dr. Gabriela Teoderescu (Rumani)
Dr. Pandi Zdruli (Itali)
Prof. as. dr. Bedri Dragusha (Kosovë)
Dr. Hazir Pollozhani (Maqedoni)
Prof. as. Dr. Sali Aliu
Prof. dr. Yllson Manoku (Shqipëri)
Dr. Ardian Harri (SHBA)
Prof. as. dr. Robert Damo (Shqipëri)
Prof. as. dr. Renata Kongoli (Shqipëri)
Prof. as. dr. Nikollaq Roshanji (Shqipëri)
Prof. as. dr. Edmond Spahiu (Shqipëri)
Dr. Spiro Gjançi (Shqipëri)

Komiteti Organizator

Prof. as. dr. Ilir Niçko (Shqipëri)
Prof. as. dr. Fehmi Xhemo (Shqipëri)
Prof. as. dr. Nevruz Zeka (Shqipëri)
Prof. as. dr. Besnik Skenderasi (Shqipëri)
Dr. Arben Kambo (Shqipëri)
Dr. Pirro Icka (Shqipëri)
Msc. Fatos Zerelli (Shqipëri)

Personi i kontaktit:

Msc. Fatos Zerelli

Universiteti "Fan S. Noli", Korçë, Shqipëri

Fakulteti i Bujqësisë

Adresa e kontaktit: icafe2015@gmail.com.

Për informacion të mëtejshëm, ju lutemi kontaktoni në icafe2015@gmail.com.

Website: www.unkorce.edu.al

Informacione për të interesuarit

- Pjesëmarrësit ftohen të paraqesin arritjet më të reja të veprimtarisë së tyre kërkimore-shkencore.
- Kumtesat duhet të jenë **origjinale, të pabotuara dhe jo në proces vlerësimi ose botimi**.
- Nga secili autor do të pranohen **jo më shumë se tre kumtesa** për të gjithë Takimin.
- Kusht i domosdoshëm për botimin e punimit është **pjesëmarrja në konferencë** e një autorit të punimit.
- Nuk do të pranohen, për asnjë arsye, kërkesa për shtyrjen e afatit të dorëzimit të Abstraktit dhe ose të punimit të plotë.
- Varianti për botim i kontributeve (materialeve shkencore) duhet të jetë në gjuhën shqipe ose angleze, i formatuar sipas rregullave të mëposhtme.

Formati i faqes: A4. Margjinat: lart e poshtë: 2,5 cm; djathtas e majtas: 3 cm

**Titulli i punimit në shqip
(dhe) Titulli i punimit në anglisht**

(14pt Times New Roman, bold, në qendër)

EMRAT E AUTORËVE (Me shkronja të mëdha, 12pt Times New Roman, në qendër)

Institucioni ose Departamenti dhe Universiteti (12pt Times New Roman, në qendër)

Adresa (12pt Times New Roman, në qendër); SHTETI (me shkronja të mëdha, 12pt Times New Roman, në qendër)

E-mail (për komunikim) (12pt Times New Roman, në qendër)

Përmbledhje: Teksti (12pt Times New Roman, normal, i rrafshuar në të dy skajet), 150-250 fjalë. (edhe)


Abstract (anglisht): Teksti (12pt Times New Roman, normal, i rrafshuar në të dy skajet), 150-250 fjalë.

Fjalët kyçe: 5-7 fjalë të renditura alfabetikisht (12pt Times New Roman, normal, i rrafshuar në të dy skajet). (edhe)

Key-words (anglisht): 5- 7 fjalë të renditura alfabetikisht (12pt Times New Roman, normal, i rrafshuar në të dy skajet).

Prezantimi në Konferencë do të jetë gojor ose poster. Koha e prezantimit gojor do të jetë 12 minuta. Pjesëmarrësit me prezantim gojor në gjuhën shqipe mund të kenë prezantimin në Power Point në gjuhën angleze.

Posterat: përmasat e fushës do të jenë 100x80 cm sipas modelit.



Rekomandime për të shkruar materialin e plotë

Materiali shkencor që do të paraqitet për tu botuar në Proceedings, si rregull, duhet të ketë elementet: Abstrakt, Hyrje, Materiale dhe Metodot, Rezultatet dhe Diskutim, Konkluzioni, i cili duhet të ofrojë një pasqyrë të qartë dhe të shkurtër të hulumtimit dhe rezultatet e marra, listën e literaturës. Materiali do të botohet në gjuhën shqipe ose angleze. Për materialin në gjuhën shqipe, abstrakti duhet të jetë edhe në gjuhën angleze. Dorëshkrimi duhet të jetë në format A4. Marxhet, lart, poshtë, majtas dhe djathtas 2,5 cm. Titujt Caps Lock, Times New Roman, Madhësia e shkronjës: 12, Bold. Nëntitujt me bold dhe Caps Lock, Times New Roman, dhe Madhësia e shkronjës: 12. Emri i autorit ose autorëve, adresa e institucionit dhe e-mail adresa në Times New Roman 12 pt, në qendër. Abstrakti (150-250 fjalë) në Times New Roman 12 pt, i rrafshuar në të dy anët. Fjalët kyç (5- 7) në Times New Roman 12 pt, Italik. Teksti kryesor duhet të jetë i shkruar në Times New Roman, Madhësia e shkronjës: 12, hapësira e rreshtave: single, me një kolonë, i rrafshuar në të dy anët. Shtrirja e një dorëshkrimi është i kufizuar deri në 8 faqe. Objekte grafike të tilla si grafikët, fotot dhe vizatimet duhet të jenë në formë elektronike dhe të vendosur në dokument drejtpërdrejt. Fotografitë ose

skanimet duhet të jenë të qarta, me kontrast, ato duhet të dorëzohen në formatin JPG me rezolucion prej 200 dpi. Tabelat duhet të etiketohen Tabela 1, Tabela 2, etj në krye të çdo tabele në - Times New Roman 12 pt bold. Rekomandohen që njësitë e përdorura të jenë në sistemin SI. Ekuacionet matematike duhen shkruar duke përdorur një program ekuacionesh.

Referencat duhen të jenë të shkruara në format e mëposhtme, në Times New Roman 11 pt.:

Revista shkencore:

Petrit S. Solar radiation over Albania and comparisons with empirical models. Energy 2008; 52(12): 77-85.

Libra:

Mengel K., Kirkby E. A. Principles of Plant Nutrition. Bern: International Potash Institute 1987.

Proceedings të konferencave apo simpoziumeve shkencore:

Streif J. Optimum harvest date for different apple cultivars in the 'Bodensee' area. In COST 94. The postharvest treatment of fruit and vegetables. Determination and prediction of optimum harvest date of apples and pears. Proceedings

Application form – ICAFE 2015

Author(s) _____
Tel. _____ Fax: _____ e-mail _____
Institution / Organization _____
Address _____
Paper title _____
Conference section (1-6) _____
Way of presentation (1-2) 1) Oral _____ 2) Poster _____
Date of filling _____

Please, fill up with printed letters,

Send the form before 04 September 201

FATURË PËR ARKËTIM

Datë _____ Nr _____

Me anë të kësaj fature kërkohet që Banka e Nivelit të Dytë të pranojë nga klientë (persona/persona fizike/persona juridike) arkëtime për llogari të institucionit tone, me emërtime, kode, numër identifikimi dhe shuma si më poshtë:

Emri i Institucionit përfitues **UNIVERSITETI "F.NOLI" KORÇE**

Kodi i Institucionit përfitues **1011046**

Kodi i Degës së Thesarit ku vepron **1010015**

Emri i pagesit (person/person fizik/person juridik) _____

Numri i Identifikimit të Pagesit _____

ID e Detyrimit	Përshkrimi i të Ardhurave		Shuma që Arkëtohet (Lekë)
	Emërtimi	Kodi i Llogarisë Ekonomike	
	Arkëtim nga Projekti Tarifë Pjesëmarrje në Konferencë	7111099	
X	Totali	X	

Përfaqësuesi i INSTITUCIONIT

(Emri / Mbiemri)

KLIENTI

(Person / Person Fizik / Person Juridik)

(Emri / Mbiemri, Nënshkrimi)

Adresa:

Kontakti: